



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 179

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E mërkurë, 23 tetor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 649, datë 16.10.2024	Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”..... 20315
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 8, datë 11.10.2024	Për miratimin e metodologjisë, kriterëve dhe procedurat, për vlerësimin dhe priorizimin e fondeve buxhetore të investimeve publike, për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve..... 20326
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 188, datë 17.10.2024	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Andrea Nesti Mano, kandidat i listës shumëmemërore të Partisë Demokratike të Shqipërisë, qarku Korçë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021..... 20351
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 191, datë 18.10.2024	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Erjon Shërbet Meka, kandidat i listës shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Durrës, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021..... 20352



VENDIM
Nr. 649, datë 16.10.2024

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR KUSHTET DHE KRITERET E
USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË
STACIONIT TË PLAZHIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 64, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vendimi nr. 171, datë 27.3.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullore ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e turizmit, Drejtoria e Përgjithshme Detare, strukturat përgjegjëse për kufirin në Policinë e Shtetit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

RREGULLORE
PËR KUSHTET DHE KRITERET E
USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË
STACIONIT TË PLAZHIT

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore përcakton kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacioneve të plazhit në të gjitha zonat bregdetare, si dhe në bregun e liqeneve e të lumenjve, të cilat janë identifikuar si zona të përshtatshme për plazhe, me qëllim ofrimin

e kushteve të përshtatshme e të standardeve cilësore për pushuesit.

Neni 2
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në nenin 4, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar.

2. Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Grupi teknik i shqyrtimit të aplikimeve” (në vijim “GTSHA”) është autoriteti i shqyrtimit të kërkesave për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi, sipas parashikimeve të këtij vendimi;

b) “Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik” është organ i krijuar sipas parashikimeve të këtij vendimi;

c) “Plazh”, zona me rërë, zhavorr apo shkëmb, që shtrihet në buzë të ujit të detit, lumit apo liqenit, e cila është pronë ekskluzive e shtetit dhe administrohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore, e hapur për përdorim të lirë publik dhe që është identifikuar si e përshtatshme për zonë çlodhjeje, argëtuese e që konsiderohet e parrezikshme nga pikëpamja shëndetësore apo e sigurisë për përdorim nga pushuesit;

ç) “Plazh i lejuar”, ku lejohet të ushtrohet veprimtaria e stacionit të plazhit, sipas kushteve dhe kriterëve të kësaj rregulloreje;

d) “Plazh publik”, zona e plazheve të lejuara dhe të administruara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të hapura për përdorim publik e që ofrojnë kërkesa minimale për sigurinë dhe higjienën;

dh) “Plazh i virgjër”, plazhi në të cilin nuk lejohet asnjë veprimtari për stacion plazhi, përveç mirëmbajtjes dhe pastrimit të mbeturinave nga njësia e vetëqeverisjes vendore, për sa është e mundur;

e) “Vrojtues plazhi” është personi i kualifikuar dhe i certifikuar nga qendrat e formimit profesional për vrojtues plazhi për të shpëtuar jetën në ujë dhe për të dhënë ndihmën e parë mjekësore;

ë) “Vendqëndrim” është hapësira tokësore në bregun e detit/liqenit, në të cilën mund të vendosen /qëndrojnë mjetet lundruese, që disponohen nga operatorët e turizmit detar, për ushtrimin e veprimtarive lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi;



f) “Zonë shërbimesh”, zona ku ndodhen shërbimet higjieno-sanitare, kabinat e veshjes dhe baret.

Neni 3

Tipologjia e plazheve

1. Plazhet, në bazë të vijës së bregut të detit ose të liqenit dhe të karakteristikave të tjera natyrore, ndahen në plazhe të tipit A, B, AB e C:

a) plazh i tipit A është plazhi kryesisht me përbërje ranore dhe me gjerësi të konsiderueshme të brezit të plazhit, i cila nuk është më i vogël se 60 (gjashtëdhjetë) m vijë perpendikulare me vijën e bregut të detit ose të liqenit;

b) plazh i tipit B është plazhi kryesisht me përbërje shkëmbore dhe zhavorri dhe me gjerësi të brezit të plazhit, i cila nuk është më i madh se 60 (gjashtëdhjetë) m vijë perpendikulare me vijën e bregut të detit ose liqenit;

c) plazh i tipit AB është plazhi i ndërthurur, i cili përmban karakteristika si të tipave A e B;

ç) plazh i tipit C është plazhi i virgjër, për përdorim të lirë, në të cilin nuk lejohet asnjë veprimtari për stacion plazhi, përveç mirëmbajtjes dhe pastrimit nga njësia e vetëqeverisjes vendore që e ka në administrim.

2. Hapësirat e plazheve të lejuara, të cilat nuk janë dhënë në përdorim për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit janë për përdorim publik dhe administrohen, menaxhohen e mirëmbahen nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

Neni 4

Harta e përgjithshme për plazhet e lejuara

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përgatisin hartën e përgjithshme për plazhet e lejuara. Kjo hartë përmban, si më poshtë vijon:

a) hapësirat e plazhit për të ushtruar veprimtari, si stacion plazhi;

b) hapësirat e plazhit publik;

c) hapësirën ujore të lejuar për notim, zonë e rrethuar me bova;

ç) vendqëndrimet e mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre.

2. Për përcaktimin e vendqëndrimeve dhe korridoreve të lëvizjes, të përcaktuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij neni, njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë me Drejtorinë e

Përgjithshme Detare dhe me strukturat e Policisë Kufitare.

3. Ndarja e sipërfaqes së plazhit të lejuar, si plazh privat/publik, do të kryhet sipas gjatësisë në vijë lineare të hartës së propozuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse, në mënyrë perpendikulare me vijën e bregut të detit/liqenit, ku në çdo 1000 m vijë lineare, 300 m vijë linear plazh përcaktohen si parcela publike, shpërndarja e të cilave në hartë vlerësohet nga njësia e qeverisjes vendore, rast pas rasti, sipas tipologjisë së secilit plazh.

4. Harta e përgjithshme e plazheve propozohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse dhe miratohet brenda muajit tetor nga Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik.

5. Agjencia Kombëtare e Bregdetit, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, deri në datën 1 maj, të çdo viti, lidh të gjitha kontratat e qirasë për përdorimin e stacionit të plazheve.

6. Plazhet, për të cilat nuk është lidhur kontratë deri në datën e përcaktuar në pikën 5, të këtij neni, funksionojnë si plazhe publike dhe administrohen / menaxhohen e mirëmbahen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Neni 5

Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik

1. Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik (në vijim “KMST”) kryesohet nga ministri i Turizmit dhe Mjedisit dhe në përbërje të tij ka përfaqësues të nivelit të lartë nga:

a) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

b) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;

c) Ministria e Mbrojtjes;

ç) Ministria e Brendshme;

d) Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

dh) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

e) ministri përgjegjës për pushtetin vendor;

dhe asistohet nga Task-Forca Ndërinstitucionale e Sezonit Turistik, e ngritur me urdhër të Kryeministrit.

2. KMST-ja këshillohet me përfaqësues të njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, ekspertë të fushës së turizmit dhe përfaqësues të institucioneve të tjera për çështjet e menaxhimit të sezonit turistik.



3. KMST-ja mbledhet periodikisht me njoftimin e kryetarit dhe i zhvillon mbledhjet në prani të shumicës së anëtarëve të saj dhe i merr vendimet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Në rastet kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

4. KMST-ja ka si detyrë:

a) miratimin e listës së plazheve dhe hartës së stacioneve të plazheve, sipas tipologjive të tyre, si dhe plazheve publike, bazuar në propozimet e njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilat pajisen me një numër të veçantë identifikues, që publikohet në momentin e hapjes së kërkesës *on-line*;

b) miratimin e afatit të lidhjes së kontratës për përdorimin e hapësirës së plazhit nga subjektet private;

c) monitorimin e mbarëvajtjes së sezonit turistik, që përfshin periudhën 1 maj deri në 15 nëntor, si dhe koordinimin ndërinstitucional për respektimin e masave dhe të detyrimeve të çdo institucioni përgjegjës, sipas detyrave funksionale respektive.

Neni 6

Njësia e vetëqeverisjes vendore

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore (në vijim “NJVV”) është përgjegjëse, për:

a) administrimin dhe menaxhimin e hapësirave të plazhit publik;

b) pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të plazhit;

c) pajisjen me infrastrukturën mbështetëse dhe ndarjen me sinjalistikën përkatëse të plazheve, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) vendosjen e sinjalistikës së dallueshme për çdo tipologji plazhi, që është plazh publik;

d) mbledhjen e detyrimeve të qirasë për çdo vit;

dh) miratimin e vendqëndrimeve të mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre, pasi të ketë marrë mendimin e Drejtorisë së Përgjithshme Detare.

2. NJVV-ja, në rast se menaxhon hapësira të konsiderueshme, si plazhe publike, garanton kushtet minimale të stacioneve të plazhit, sipas tipologjisë dhe kërkesave të sigurisë, të parashikuara në këtë rregullore. Pjesa tjetër e plazhit publik mirëmbahet nga NJVV-ja, duke siguruar vendosjen e tabelave informuese, sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.

3. Policia Bashkiake e NJVV-së përkatëse është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe ruajtjen e hapësirave të plazheve publike, si dhe marrjen e masave të menjëhershme për rastet e parashikuara në pikat 5 dhe 6, të nenit 8, të kësaj rregulloreje.

Neni 7

Kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit

1. Në stacionin e plazhit ushtrojnë veprimtarinë subjektet që plotësojnë kriteret e kësaj rregulloreje dhe që lidhin një kontratë qiraje për përdorimin e hapësirës së plazhit, në varësi të kapacitetit të strukturës akomoduese, si dhe, rast pas rast, njësitë e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

2. Në rastin e kërkesave të projekteve me potencial strategjik, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, apo kërkesave të investitorëve në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, kontrata për përdorimin e hapësirës së plazhit lidhet sipas akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse.

3. Kur veprimtaria e stacionit të plazhit ushtrohet nga subjekt privat, subjekti përmbush kriteret, si më poshtë:

a) Të jetë i regjistruar si person fizik/tregtar apo juridik për ushtrimin e veprimtarisë, si strukturë akomoduese;

b) Të disponojë një strukturë akomoduese të kategorizuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, me hapësirë plazhi para/në afërsi të strukturës akomoduese;

c) Të ketë shlyer të gjitha detyrimet tatimore qendrore dhe detyrimet vendore;

ç) Të ketë një plan operimi për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, duke përfshirë kushtet minimale dhe kërkesat e sigurisë për stacionin e plazhit.

4. Autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për dhënie në përdorim të stacionit të plazhit është GTSHA-ja, i cili ka në përbërje 5 (pesë) përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe asistohet nga sekretariati teknik. Përbërja nominale caktohet nga titullari i agjencisë.

5. GTSHA-ja, në dhënie në përdorim të hapësirës së plazhit, për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit:

a) i jep përparësi sipas radhës:



i. subjektit që disponon një strukturë akomoduese të kategorizuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, me hapësirë plazhi para strukturës akomoduese;

ii. subjektit që disponon një strukturë akomoduese të kategorizuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, me hapësirë plazhi në afërsi të strukturës akomoduese;

b) cakton dhe miraton numrin e çadrave, në varësi të numrit të dhomave të deklaruara nga subjekti. Për përcaktimin e numrit të çadrave GTSHA-ja mban në konsideratë numrin e dhomave të strukturës akomoduese, duke e llogaritur në raportin 1 dhomë, 2 çadra.

6. Subjekti që plotëson kriteret e parashikuara në pikën 3, të këtij neni, aplikon në portalin “*e-Albania*” për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi, brenda afatit/eve të përcaktuar/a, në njoftimin në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

7. Në fazën e parë të aplikimit, subjekti ngarkon në portalin “*e-Albania*” dokumentacionin e mëposhtëm:

a) formularin e kërkesës *on-line*, sipas numrit përkatës identifikues të stacionit të plazhit, duke specifikuar kapacitetin e strukturës akomoduese, numrin e dhomave;

b) planin e operimit për ushtrimin e veprimtarisë, si stacion plazhi, sipas formatit të publikuar *on-line*;

c) foto të jashtme të qarta të strukturës akomoduese, të cilat identifikojnë strukturën akomoduese, në raport me hapësirën e plazhit, si dhe foto të qarta të hapësirës së plazhit, për të cilën aplikohet:

ç) vetëdeklarimin se subjekti është njohur me kushtet, kriteret dhe kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit dhe mban përgjegjësi të plotë për plotësimin dhe zbatimin tyre, sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

8. GTSHA-ja, për shqyrtimin e kërkesave, ndjek procedurën e mëposhtme:

a) shqyrton dokumentacionin e paraqitur brenda 7 (shtatë) ditëve. Në rast se konstatohet mungesë apo pasaktësi dokumentacioni, njofton menjëherë subjektin nëpërmjet portalit *e-Albania* për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm. Subjekti plotëson dokumentacionin e nevojshëm brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit;

b) në rast se subjekti nuk plotëson dokumentacionin brenda afatit të kërkuar, kërkesa

konsiderohet si e paregjistruar dhe i kthehet subjektit bashkë me aktet e tjera nëpërmjet portalit “*e-Albania*”;

c) në rast se subjekti i plotëson kriteret dhe dokumentacioni i paraqitur rezulton i plotë, GTSHA-ja njofton subjektin nëpërmjet portalit “*e-Albania*” për fazën e dytë të procedurës dhe njofton elektronikisht njësinë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, që subjekti është kualifikuar në fazën e parë.

9. Në fazën e dytë të aplikimit subjekti, brenda datës 31 mars, ngarkon në portalin “*e-Albania*” dokumentacionin e mëposhtëm:

a) planvendosjen përkatëse të stacionit të plazhit, e cila përgatitet nga njësia e vetëqeverisjes vendore, ku specifikohet numri i çadrave, duke mbajtur në konsideratë distancat e parashikuara në këtë rregullore dhe sipërfaqen konkrete, e cila nuk duhet të tejkalojë numrin e çadrave të miratuara të stacionit të plazhit dhe të jetë në mënyrë perpendikulare me bregun e detit/liqenit. Në rastet kur në parcelë, objekt kërkesë, është miratuar paraprakisht më shumë se një subjekt përfitues, NJVV-ja mirë-përcakton planvendosjen përkatëse të stacionit të plazhit për secilin prej tyre;

b) gjenerimin e mandatpagesës vjetore të sipërfaqes së stacionit të plazhit nga ana e NJVV-së, si palë përfituese, sipas tarifave vendore në fuqi, ku detajohet detyrimi financiar vjetor për përdorimin e sipërfaqes së stacionit të plazhit dhe vërtetimi i pagesës së kryer nga ana e subjektit;

c) vërtetimin nga autoritetet tatimore se subjekti ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore qendrore dhe detyrimet vendore;

ç) marrëveshjen e noterizuar me vrojtuesin e plazhit, shoqëruar me certifikatën përkatëse të kualifikimit, e vlefshme përgjatë gjithë kohëzgjatjes, sipas afatit të parashikuar në pikën 14, të këtij neni.

10. GTSHA-ja është përgjegjëse për sigurimin e dokumentacionit, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 3, të këtij neni.

11. Pas plotësimit të dokumentacionit të mësipërm, GTSHA-ja miraton në portalin “*e-Albania*” aplikimin përkatës dhe AKB-ja njofton menjëherë subjektin dhe NJVV-në për nënshkrimin e kontratës. Modeli kontratës tip që AKB-ja nënshkruan me subjektin është sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje.

12. Dorëzimi i hapësirës së plazhit bëhet, si më poshtë vijon:



a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës, topografi i njësise përkatëse të vetëqeverisjes vendore ndan me procesverbal në terren koordinatat e stacionit të plazhit dhe njofton Policinë Bashkiake për monitorimin e veprimtarisë;

b) një kopje e procesverbalit depozitohet pranë zyrës qendrore të AKB-së, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga momenti hartimit të tij.

13. Kontrata për dhënien në përdorim të hapësirave të plazhit nënshkruhet me afat nga 1 (një) deri në 5 (pesë) vjet, sipas vendimmarrjes të KMST-së.

14. Periudha, brenda të cilës ushtrohet veprimtaria e stacionit të plazhit, është nga 1 maj deri më 15 nëntor të çdo viti dhe kur subjekti ushtron veprimtarinë ofron të gjitha shërbimet dhe përmbushen të gjitha kushtet minimale, të përcaktuara në bazë të tipologjisë së plazhit ku do të ushtrohet aktiviteti.

Neni 8

Kushtet minimale të stacionit të plazhit, sipas tipologjisë së plazhit

1. Kushtet minimale, që duhet të përmbushë një stacion plazhi, në plazhet e tipit A, janë, si më poshtë vijon:

a) për çadrat dhe ndenjëset e pushuesve të respektohet një distancë prej të paktën 10 (dhjetë) m nga vija e bregut të detit/liqenit;

b) hapësira prej 2.5 (dy pikë pesë) m përpara brezit të parë të çadrave të jetë e lirë për t'u shfrytëzuar nga publiku;

c) hapësira midis çadrave (nga çadra në çadër) nuk duhet të jetë më e vogël se 3 (tre) m në linjë horizontale me vijën e ujit, si dhe jo më e vogël se 2.5 (dy pikë pesë) m në linjë vertikale me vijën e ujit;

ç) të ketë në dispozicion të pushuesve 1 (një) dush me ujë të ëmbël;

d) të jetë i pajisur me shërbime higjienike, minimalisht të ketë 1 tualet, të ndarë në njësi për femra dhe meshkuj, dhe 1 (një) për njerëzit me aftësi të kufizuar; njësia për njerëzit me aftësi të kufizuar mund të përfshihet në secilën njësi për femra dhe meshkuj, duke rritur sipërfaqen e këtyre njësive të shërbimit, në dimensionet maksimale 1,80 m x 1,80 m;

dh) të ketë kabina zhveshjeje, sipërfaqja totale e kabinave të zhveshjes nuk duhet të jetë më e vogël

se 1 (një) % e sipërfaqes së hapësirës së plazhit të dhënë në përdorim;

e) të jetë i pajisur me zonën e ndihmës së shpejtë në shërbim të pushuesve, si dhe me pajisjet përkatëse për dhënien e ndihmës së shpejtë për pushuesit; ky ambient duhet të jetë lehtësisht i aksesueshëm dhe i identifikueshëm e të lihen korridore të lira kalimi për transportin, në raste emergjence;

ë) prania e tabelave informuese, të vendosura në vende të dukshme, me numrat e telefonit të ambulancës, policisë, zjarrfikëses, Kapitenarisë së Portit, Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare;

f) të jetë i pajisur me kontejnerë dhe kosha me kapak për hedhjen e mbeturinave;

g) çdo çadër duhet të jetë e pajisur me 2 (dy) krevate plazhi;

gj) të afishojë kriteret dhe kushtet e sigurisë së shëndetit dhe jetës për aspektet teknike të veprimtarisë së stacionit të plazhit;

h) të ekspozojë në vend të dukshëm për publikun emrin e biznesit, si dhe procedurën e ankimit të paktën në gjuhët shqipe dhe angleze;

i) të ekspozojë dukshëm listat e çmimeve për produktin dhe shërbimin, që ofron të paktën në gjuhët shqipe dhe angleze.

j) stafi që shërben pranë stacioneve të plazhit të ketë uniforme dalluese;

k) të zbatojë kodin e etikës globale në fushën e turizmit;

l) detyrimin të mirëmbajtje dhe të parandalojë ndotjen e hapësirës së plazhit që ka marrë në përdorim nëpërmjet shërbimit për pastrimin dhe mirëmbajtjen e stacionit të plazhit çdo ditë, në mëngjes dhe në mbrëmje pas mbylljes së plazhit. Po ashtu, gjatë orarit të hapjes së stacionit të plazhit duhet të sigurohet vazhdimësia e pastërtisë dhe boshatisja e koshave të mbeturinave;

ll) në të gjithë territorin e plazhit të ndalohet vendosja e elementeve ndarëse, gardhe apo të tjera të ngjashme me to.

2. Kushtet minimale, që duhet të plotësojë një stacion plazhi, në plazhet e tipit B, janë, si më poshtë vijon:

a) për çadrat dhe ndenjëset e pushuesve, në varësi të hapësirës, të respektohet një distancë prej 2.5-3 m nga vija e bregut të detit, liqenit;

b) hapësira midis çadrave (nga çadra në çadër) duhet të jetë të paktën 2.5 (dy pikë pesë) m;



c) të gjitha kushtet e përcaktuara për tipin A, sipas pikës 1, të këtij neni, përveç shkronjave “b” dhe “c”.

3. Kushtet minimale, që duhet të plotësojë një stacion plazhi, në plazhet e tipit AB, janë, si më poshtë vijon:

a) për hapësirat, të cilat përmbajnë elementet e tipologjisë së plazhit të tipit A, do të zbatohen kriteret e plazhit të tipit A, sipas pikës 1, të këtij neni;

b) për hapësirat, të cilat përmbajnë elementet e tipologjisë së plazhit të tipit B, do të zbatohen kriteret e plazhit të tipit B, sipas pikës 2, të këtij neni.

4. Për plazhin e tipit C, njësia e vetëqeverisjes vendore merr masa për vendosjen e tabelave informuese, të vendosura në vende të dukshme, me numrat e telefonit të ambulancës, policisë, zjarrfikëses, Kapitenarisë së Portit, Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare.

5. Nuk mund të ndalohet apo të kufizohet, në asnjë formë dhe në asnjë kohë, akses i publikut në hapësirat e plazheve. Subjektet e veprimtarisë së stacionit të plazhit kanë detyrimin për të krijuar kushtet e kalimit lirisht të publikut dhe moscenimin në ndonjë formë të kësaj të drejte, si dhe sigurimin e kushteve të kalimit lirisht të personave me aftësi të kufizuar.

6. Në rastin e bllokimit të rrugëve ekzistuese nga subjektet ushtruese të veprimtarisë së stacionit të plazhit, njësia e vetëqeverisjes vendore merr masa të menjëhershme për lirin e këtyre rrugëve vullnetarisht nga këto subjekte ose të ndërtimit të rrugëve të reja, me parametrat e duhur për të mundësuar aksesin e publikut në plazh.

7. Në stacionet e plazhit, në hapësirën midis bregut dhe zonës së çadrave, nuk lejohen shitësit ambulantë.

Neni 9

Kërkesat për sigurinë në stacionet e plazhit

1. Të gjitha stacionet e plazhit kanë detyrimin e vendosjes, mirëmbajtjes dhe ruajtjes së kushteve higjienike dhe të sigurisë për jetën, të caktuara në këtë rregullore, si dhe kanë detyrë të ruajnë pastërtinë e detit dhe bregut të detit për zonën para stacionit të plazhit, si dhe ta mbrojnë atë nga ndotjet e dëmtimet me shpenzimet e tyre.

2. Kërkesat për sigurinë, të përcaktuara në këtë nen, zbatohen edhe për plazhet publike.

3. Të gjitha stacionet e plazhit duhet të garantojnë shërbimin me vrotues plazhi përgjatë gjithë kohës

që subjekti ushtron aktivitetin e tij, për çdo 80 (tetëdhjetë) m vijë lineare bregdetare. Për stacionet e plazhit, me vijë lineare bregdetare mbi 80 (tetëdhjetë) m, pajisjen me pika vrojtimi për çdo fraksion 80 (tetëdhjetë) m linear. Edhe stacionet e plazhit me vijë lineare bregdetare nën 80 (tetëdhjetë) m kanë detyrimin të kenë vrojtues plazhi.

4. Të gjitha stacionet e plazhit duhet të kenë:

a) sinjalizimin dhe kufizimin me bova, me diametër 22 cm, me ngjyrë të kuqe, të lidhura me litar pluskues me njëra-tjetrën, çdo 30–50 m të hapësirës ujore përpara stacionit të plazhit të dedikuar për not, e cila duhet të jetë deri në:

i. 200 (dyqind) m nga bregu për plazhet e tipit A;

ii. 100 (njëqind) m nga bregu për plazhet e tipit B,

deri në thellësinë 1.6 m (një pikë gjashtë) të vendosen bova, me diametër 22 cm, me ngjyrë të bardhë, e cila sinjalizon pushuesit për zonën e sigurt për notim. Bovat duhet të jenë të mirankoruara dhe të kontrollohen periodikisht, nëse ato kanë lëvizur nga pozicioni i tyre nga dallgët, era apo shkaqe të tjera.

b) sinjalizimin e zonave të përdorimit të mjeteve lundruese për argëtim, zonat për përdorimin dhe vendqëndrimin e mjeteve lundruese me ose pa motor, jashtë zonave të përcaktuara për not sipas shkronjës “a”, më sipër, duhet të jenë të kufizuara, duke ofruar vende për qëndrim në tokë dhe bova për përcaktimin e vendqëndrimeve dhe korridoreve për afrimin dhe parkimin në tokë të mjeteve ujore me ose pa motor. Në zonat e përdorimit dhe vendqëndrimeve të mjeteve lundruese për argëtim, aktivitetet e notimit janë të ndaluara. Sinjalizimin me tabela informuese në shqip dhe në anglisht, në vend të dukshëm pranë bregut të detit “Zonë e ndaluar për notim” dhe “No swimming area”;

c) vendosjen e flamujve me shkop, çdo ditë, gjatë sezonit të verës; subjekti që ushtron veprimtarinë e stacionit të plazhit duhet të vendosë një flamur, në përputhje me kushtet e motit dhe të detit, i cili mund të ndryshohet gjatë ditës, nëse ndryshojnë kushtet e motit apo të detit, si më poshtë vijon:

i. flamur i gjelbër – lejohet notimi;

ii. flamur i verdhë – notim me masa mbrojtëse;

iii. flamur i kuq – ndalohet notimi.

Në shkopin e flamurit duhet të ketë edhe një tabelë sqaruese në shqip dhe anglisht për sinjalistikën me flamur dhe me informacion për



kushtet e plazhit. Shkopi i flamurit duhet të jetë 3.5 m i lartë, i dukshëm në të gjithë zonën.

ç) pajisjen e çdo stacioni të plazhit me pikë vrojtimi, pajisjet e të cilave janë përcaktuara në shtojcën nr.2, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje. Pika e vroitimit duhet:

i. të jetë e vendosur në pozicion qendror, referuar strukturës së stacionit të plazhit ose vijës bregdetare në përdorim;

ii. të jetë e avancuar në krahasim me vijën e parë të çadrave;

iii. të ketë një fushë pamjeje dhe veprimi të lirë;

iv. të jetë mbulesa e çadrës ose tendës së pikës së vroitimit me pëlhurë të kuqe, lehtësisht e identifikueshme, ku të shkruhet qartë “VROJTUES PLAZHI”/ “LIFEGUARD”.

d) pajisjen e plazheve publike me pika vrojtimi, pajisjet e të cilave përcaktohen në shtojcën nr.2, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje. Distanca për pajisjen me pikavrojtimi në këto plazhe, për aq sa është e mundur, do të jenë sa distancat e parashikuara për pikat e vroitimit në stacionet e plazhit dhe duhet të ketë lartësi 3 m dhe fushë pamjeje e veprimi të lirë;

dh) garantimin e shërbimit me vrojtues plazhi në çdo “stacion plazhi” dhe “plazh publik”. Vrojtuesi i plazhit punësohet nga subjekti publik dhe privat që ka në përdorim/administrim hapësirën e plazhit dhe duhet të garantojë përgjatë gjithë periudhës së ushtrimit të veprimtarisë së plazhit. Në mungesë të shërbimit me vrojtues plazhi, struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e turizmit merr masa administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin dhe legjislacionin në fuqi për turizmin.

6. Për plazhet publike, të cilët administrohen nga njësitë vendore dhe plazhet e tipit C, në të cilat nuk mund të ofrohen kriteret e sigurisë, duhet të vendosen tabela informuese lehtësisht të dallueshme, me mbishkrime (shqip dhe në anglisht) “KUJDES! – KY PLAZH NUK KA VROJTUES PLAZHI”/“ATTENTION! - THIS BEACH HAS NO LIFEGUARD”.

7. Çdo stacion plazhi dhe pikë vrojtimi duhet të ketë të afishuar:

7.1. Kanalet për komunikim emergjence, si:

a) shërbimi i urgjencës mjekësore;

b) Policia e Shtetit dhe strukturat përgjegjëse për kufirin në Policinë e Shtetit;

c) zjarrfikëset;

ç) Kapitenaria Detare;

dh) Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare.

7.2. Në mënyrë të dukshme, këshillat drejtuar pushuesve, në gjuhën shqipe dhe angleze, si më poshtë vijon:

a) Noto vetëm në zonat e autorizuara dhe me sinjalistikë;

b) Respekto flamurin dhe informacionin e afishuar;

c) Ndalohet notimi nën ndikimin e alkoolit apo drogave;

ç) Mos noto, nëse ke ndonjë problem fizik;

d) Pusho për një orë pas ngrënies, para se të shkosh për notim;

dh) Të miturit nën 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjeç duhet të jenë gjithmonë nën mbikëqyrjen e më të rriturve;

e) Mos u hidh nga shkëmbinj apo platforma, përveç vendeve të autorizuara me sinjalistikë;

ë) Ndiq udhëzimet e vrojtuesit (rojës së shpëtimit të jetës);

f) Mbjaj pastër mjedisin;

g) Në rast emergjence në det, telefono 112.

8. Lejohet aktiviteti i dhënies me qira të pedaloneve apo i mjeteve të tjera ujore jomotorike dhe përdorimi i tyre duhet të bëhet jashtë zonës së notimit, bazuar në aktet nënligjore në fuqi.

9. Lëvizja e motorëve të ujit apo varkave motorike duhet të bëhet nga vendqëndrimet dhe korridoret hyrëse/dalëse, të miratuara nga NJVV-ja përkatëse.

10. Ofrimi i shërbimeve dhe plotësimi i kushteve, të përmendura më sipër, bëhet me shpenzimet e mbajtësit të autorizimit të stacionit të plazhit.

11. Kontrata e përdorimit të hapësirës së plazhit mund të parashikojë kriteret më të detajuara të stacionit të plazhit, sipas tipologjisë së plazhit.

Neni 10

Detyrat e vrojtuesit të plazhit

Vrojtuesi i plazhit ka si detyrim:

a) të ketë njohuri për kuadrin ligjor të funksionimit të stacionit të plazhit, teknikat e shpëtimit dhe dyluftimit në ujë, dhënien e ndihmës së parë mjekësore, për hidrometeorologjinë, karakteristikat e brigjeve shqiptare dhe rrymat ujore në to, si dhe për sigurinë e mjedisit ujor, me referim



të veçantë për të njohur faktorët e rrezikshëm që mund të jenë të pranishëm në ujë;

b) të jetë i angazhuar ekskluzivisht në shërbim të vrojtim-shpëtimit dhe të jetë i pranishëm përgjatë gjithë kohës pranë pikës së vrojtim, përjashtuar rastet emergjente;

c) të mbajë të veshur uniformën e vrojtuesit me ngjyrë të kuqe gjatë shërbimit. Uniforma ka të shkruar në pjesën e përparme logon, në krahun e majtë simbolin e flamurit shqiptar, në krahun e djathtë numrin e matrikullës dhe në pjesën e pasme, në mënyrë të dukshme qartë, “Vrojtues plazhi” dhe “*Lifeguard*”;

ç) të sinjalizojë pranë organeve kompetente, në rastet kur verifikohen kundërvajtje në territorin e stacionit të plazhit dhe në hapësirën ujore përballë tij;

d) të kujdeset periodikisht për sinjalistikën ujore dhe territoriale të stacionit të plazhit dhe të bëjë zëvendësimin e materialeve të konsumuara në kutinë e ndihmës së shpejtë mjekësore, si dhe të mbajë në eficiencë mjetet e shpëtimit;

dh) të ketë certifikatën dhe kartën ekuivalente të certifikatës, brenda afatit të vlefshmërisë, lëshuar nga qendrat e formimit profesional. Rinovimi i saj bëhet sipas rregullores së subjektit certifikues, me qëllim monitorimin e aftësive fizike, mendore të vrojtuesit.

Neni 11

Kritere të përgjithshme për strukturat në stacionet e plazhit

1. Strukturat dhe pajisjet e përdorura në stacionin e plazhit, përveç instalimeve sanitare publike dhe pikat e vrojtim, duhet të çmontohen me përfundimin e afatit të parashikuar në kontratë për sezonin e plazhit të vitit respektiv, për t'i kthyer plazhit karakterin e tij natyror.

2. Strukturat e përdorura duhet të jenë:

a) struktura lehtësisht të çmontueshme, të realizuara me elemente, të tilla, si druri, panele të parafabrikuara të lehta, mbulesa të lehta, PVC, që nuk e dëmtojnë mjedisin në momentin e zhvendosjes;

b) pajisje të lëvizshme, të instalueshme vetëm për periudhën e sezonit të plazhit dhe të cilat mund të hiqen me mbylljen e tij, si çadra, krevate plazhi, tavolina, akseset për të shkuar në det, struktura të vogla prej druri etj.;

c) struktura të sigurt, të kenë sistemet e montimit me bulona, strukturat e shërbimeve mund të jenë të përkohshme.

3. Në stacionet e plazheve mund të ketë 3 tipologji çadrash:

a) me kashtë;

b) me pëlhurë, tekstil;

c) tendë kashte apo pëlhure.

4. Brenda brezit të shërbimeve mund të realizohen këto struktura: kioskë menaxhimi për plazhin, kabina, shërbime higjienike, depo, pika vrojtimi, hapësirë për rojën e plazhit në rastin e plazhit publik, strukturë shërbimi/bar, hapësirë për fëmijët, hapësira relaksimi me tavolina, hapësirë për vendosjen e biçikletave. Materialet që lejohen të përdoren për këto struktura janë: dru, kashtë, kallama, tenda të lehta, struktura të çmontueshme, në mënyrë që të magazinohen gjatë sezonit të dimrit dhe të transportohen përgjatë zonës bregdetare, në rast nevojë.

Neni 12

Respektimi i kushtit për nivelin e lejuar të zhurmave

Çdo stacion plazhi është i detyruar të respektojë nivelin kufi të zhurmave, të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për zhurmat, si dhe/ose në planet vendore, të miratuara nga organet e vetëqeverisjes vendore.

Neni 13

Inspektimi

1. Struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e turizmit kryen inspektime për të verifikuar respektimin e kushteve dhe kritereve, të përcaktuara në këtë rregullore, nga subjektet që kanë lidhur një kontratë qiraje/përdorimi të hapësirës për stacion plazhi.

2. Në rast konstatimi të shkeljeve, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, struktura përgjegjëse inspektuese merr masa administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin dhe parashikimet e nenit 71, të ligjit nr.93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, e, në rast përsëritjeje të shkeljeve administrative deri në zgjidhjen e menjëhershme të kontratës.



Neni 14

Dispozitë kalimtare

1. Përjashtimisht, për vitin 2024, afati kohor i miratimit të hartës, sipas pikës 4, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, do të jetë brenda muajit nëntor.

2. Subjektet, të cilët kanë kontratë të vlefshme qiraje/përdorimi të hapësirave të stacionit të plazhit, deri në vitin 2025, do të zhvillojnë aktivitetin e tyre deri në përfundimin e afatit të kontratës, duke respektuar kushtet dhe kërkesat e parashikuara në këtë rregullore.

3. Përjashtimisht, për bashkitë Fier dhe Divjakë, në stacionet e plazhit, që nuk ka struktura akomoduese pranë apo në afërsi të hapësirës së plazhit, nuk zbatohet kriteri i parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 3, të nenit 7, dhe subjekti, përveç kriterëve të parashikuara në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 3, të nenit 7, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë i regjistruar si person fizik/tregtar apo juridik për ushtrimin e veprimtarisë, si strukturë shërbimi;

b) të disponojë një strukturë shërbimi me kapacitet mbi 20 tavolina dhe të ketë hapësirë plazhi pranë strukturës së shërbimit.

4. Subjektet e parashikuara në pikën 3, të këtij neni, paraqesin kërkesën me shkrim pranë Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe për dijeni NJVV-së, së bashku me dokumentacionin, që vërteton plotësimin e kriterëve të parashikuara në këtë rregullore. GTSHA-ja është përgjegjëse për sigurimin e ekstraktit të regjistrimit, sipas shkronjës “a”, të pikës 3, të këtij neni. Agjencia Kombëtare e Bregdetit i përcjell për shqyrtim kërkesën GTSHA-së dhe për trajtimin e aplikimit ndiqet e njëjta procedurë e parashikuar në nenin 7, të kësaj rregulloreje. Numri maksimal i çadrave që vendosen në stacionin e plazhit pranë strukturës së shërbimit është 50 çadra.

SHTOJCA I

**KONTRATA MODEL PËR PËRDORIMIN
E HAPËSIRËS SË PLAZHIT**

Sot, më datë [•], në [•], nënshkruhet kjo kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit (kontrata) ndërmjet palëve, si më poshtë:

Agjencia Kombëtare e Bregdetit, përfaqësuar nga z./znj. [•], në cilësinë e drejtorit të Agjencisë, këtu e më poshtë referuar si “dhënësi”

dhe

[•] person fizik/tregtar apo juridik, i/e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me numër unik identifikimi [•], me seli në adresën: [•], përfaqësuar nga z./znj. [•], në cilësinë e përfaqësuesit ligjor, këtu e më poshtë referuar si “përdoruesi”

dhe

njësia e vetëqeverisjes vendore, përfaqësuar nga , këtu e më poshtë, referuar si “përfituesi”,

Megjithatë:

A) Përdoruesi operon një strukturë akomoduese apo një strukturë shërbimi, sipas pikës 3, të nenit 7, apo të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 14, të rregullores, miratuar me vendimin nr.[•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, të ndodhur në [•], me një kapacitet prej [•] dhomash/tavolinash;

B) Mbështetur në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, përdoruesi ka aplikuar nëpërmjet portalit “e-Albania”/ apo për parashikimet e pikës 4, të nenit 14, të rregullores, miratuar me vendimin e mësipërm, ka depozituar kërkesën pranë Agjencisë Kombëtare të Bregdetit për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit prej [•] m², të ndodhur në [•];

C) Përdoruesi, mbështetur në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes, është njoftuar, në datën [•], për miratimin e kërkesës për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit prej [•] m² të ndodhur në [•].

Për sa më sipër dhe bazuar në parashikimet e nenit 659 e në vijim të Kodit Civil, palët bien dakord, si më poshtë vijon.

Neni 1

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është dhënia në përdorim e hapësirës së plazhit, të ndodhur në [•], me sipërfaqe prej [•] m², në administrim të Bashkisë____, bazuar në hartën e miratuar nga Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik.



Neni 2 Qëllimi i përdorimit

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në përdorim e hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores, Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”.

Neni 3 Kohëzgjatja

1. Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë prej ____ viti/vjetësh, me të drejtë përdorimi, të paktën për periudhën 1 maj–15 tetor të çdo viti, dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët.

2. Palët bien dakord që kontrata do të përfundojë me përfundimin e afatit dhe nuk rinovohet.

Neni 4 Të drejtat dhe detyrimet e përfituesit

1. Përfituesi gëzon të drejtën e përfitimit të pagesës vjetore për stacionin e plazhit, objekt i kësaj kontrate.

2. Përfituesi ka detyrimin të dorëzojë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, hapësirën e plazhit të përcaktuar në nenin 1, të lirë për t’u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit hartohet procesverbali i dorëzimit të hapësirës së plazhit që jepet në përdorim.

3. Përfituesi dorëzon një kopje të procesverbalit të “dhënësi”, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dorëzimi i hapësirës së plazhit.

4. Përfituesi ka detyrimin të mbikëqyrë vendosjen e numrit të çadrave, të miratuara nga GTSHA-ja për stacionin e plazhit, objekt i kësaj kontrate gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj.

5. Përfituesi i garanton përdoruesit gëzimin e qetë të hapësirës së plazhit, objekt të kontratës gjatë gjithë periudhës së dhënë në përdorim.

6. Përfituesi garanton aksesin e publikut në hapësirën e plazhit, objekt kontrate, dhe merr masa të menjëhershme në rast bllokimi të rrugëve, sipas parashikimeve të nenit 8, të vendimit nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e

rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”.

Neni 5 Të drejtat dhe detyrimet e dhënësit

1. Dhënësi ka të drejtë të kontrollojë dhe monitorojë në çdo kohë respektimin e kushteve, kërkesave dhe kriterëve të ushtrimit të veprimtarisë, të përcaktuara në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”.

2. Dhënësi ka detyrimin të bashkëpunojë me përfituesin për respektimin e parashikimeve të vendimit nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”.

Neni 6 Të drejtat dhe detyrimet e përdoruesit

1. Përdoruesi ka të drejtë të përdorë e të gëzojë hapësirën e stacionit të plazhit, të marrë në përdorim dhe përmirësimet e bëra në të për gjithë kohëzgjatjen e kontratës.

2. Përdoruesi detyrohet që:

a) të përdorë hapësirën e plazhit, objekt të kësaj kontrate, vetëm për qëllimin e parashikuar në nenin 2;

b) të ushtrojë veprimtarinë në përputhje me planin e operimit, të paraqitur në momentin e aplikimit për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit;

c) të plotësojë e të respektojë kushtet minimale të stacionit të plazhit sipas tipologjisë, kërkesat e sigurisë në stacionet e plazhit dhe kriteret e përgjithshme për strukturat në stacionet e plazhit në përputhje me vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”;

ç) të respektojë kushtet për nivelin e lejuar të zhurmave, sipas akteve ligjore/nënligjore në fuqi;

d) të bashkëpunojë me çdo autoritet publik përgjegjës për monitorimin dhe inspektimin e plazhit e të veprimtarive turistike, si dhe t’i vërë në dispozicion të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm për të verifikuar përmbushjen e detyrimeve ligjore përkatëse;



dh) të paraqesë çdo dokumentacion të nevojshëm për përmbushjen e kriterëve dhe standardeve minimale për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, në rast kontrolli apo inspektimi nga organet përgjegjëse;

e) të ketë të punësuar vrojtues plazhi përgjatë gjithë sezonit të ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit;

ë) të afishojë certifikatën e kualifikimit të vrojtuesit të plazhit ose kopja e saj, së bashku me NIPT-in dhe lejet që ai disponon;

f) të krijojë kushte për kalimin lirisht të publikut dhe të moscenojë në ndonjë formë këtë të drejtë, si dhe të sigurojë kushte të kalimit lirisht të personave me aftësi të kufizuara.

3. Përdoruesi nuk ka të drejtë të japë me nënqira hapësirën e plazhit të marrë në përdorim, sipas kësaj kontrate.

Neni 7

Penalitetet

1. Në rast të mospërmbushjes së detyrimeve, të përcaktuara në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, ndaj përfituesit zbatohen parashikimet e legjislacionit në fuqi për inspektimin dhe nenit 71, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar.

2. Në rast se konstatohet që masat për përmbushjen e detyrimeve vazhdojnë të mos realizohen nga përdoruesi, dhënësi vetë apo nëpërmjet njoftimit nga përfituesi ka të drejtë të zgjidhë menjëherë kontratën për mospërmbushje të detyrimit kontraktor.

Neni 8

Zgjidhja e kontratës

1. Kontrata zgjidhet me përfundimin e afatit, të përcaktuar në nenin 3, të kontratës.

2. Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

a) me marrëveshje midis palëve;

b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet, për shkak të një force madhore, aq sa nuk mund të ushtrohet veprimtaria e stacionit të plazhit;

c) kur përdoruesi shkel në mënyrë të përsëritur detyrimet e marra përsipër sipas kontratës, mbështetur në kushtet, kërkesat dhe kriteret e parashikuara në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit

të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”.

3. Dhënësi apo përfituesi kanë të drejtë të kërkojnë zgjidhjen e kontratës kur përdoruesi shkel detyrimet e marra përsipër. Në këtë rast, dhënësi apo përdoruesi respektojnë procedurën e parashikuar në legjislacionin në fuqi për inspektimin.

4. Kontrata mund të zgjidhet nga dhënësi edhe për shkaqe të interesit publik. Në këtë rast, përdoruesi ka të drejtën e rimbursimit të pagesës së kryer nga përfituesi për afatin e mbetur.

5. Me përfundimin e kontratës, përdoruesi duhet të kthejë hapësirën e plazhit në të njëjtën gjendje që e ka marrë në dorëzim, në të kundërt, detyrohet të kryejë të gjitha rregullimet me shpenzimet e veta ose të paguajë vlerën përkatëse të shpenzimeve të përcaktuara me një ekspert të emëruar me marrëveshje dypalëshe.

6. Me përfundimin e kontratës, përdoruesi ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga hapësira e plazhit, por pa dëmtuar atë. Dhënësi nuk bën kompensimin financiar të investimeve të kryera nga përdoruesi.

Neni 9

Dispozitat e fundit

1. Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në kontratë, palët do t'u referohen dispozitave të Kodit Civil dhe vendimit nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”.

2. Kontrata përbën marrëveshjen e plotë ndërmjet palëve lidhur me objektin e saj dhe ka epërsi mbi çdo marrëveshje të mëparshme, me gojë apo me shkrim midis palëve.

3. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet palëve, lidhur me kontratën apo ndonjë marrëveshje tjetër ose dokumenti të nënshkruar nga palët për zbatimin e kontratës, do të zgjidhet nga palët me mirëkuptim, në të kundërt, zgjidhja e mosmarrëveshjes do të jetë në kompetencën e gjykatës administrative përkatëse.

4. Kontrata është hartuar në katër kopje origjinale, në gjuhën shqipe, me të njëjtën vlerë secila.



SHTOJCA II

Pika e vrojtimit duhet të ketë këto pajisje:

- a) një barelë pluskuese shpëtimi;
- b) 2 kamerdare rrethshpëtimi 63 = cm me litar pluskues 15–25 m të gjatë;
- c) një bovë *baywatch*;
- ç) një palë dylbi;
- d) një megafon;
- dh) bilbil plastik;
- e) një rul statik, me jo më pak se 200 m litar pluskues të gjatë në të;
- ë) një mjet pluskues shpëtimi (*surfboard* ose pedalon);

f) kutinë e ndihmës së shpejtë mjekësore (2 bombola oksigjeni mbi 1 L, 150 atm, me reduktor presioni me manometër kontrolli, pompë dore oksigjenimi, hapëse goje, poker mask, aparat matës tensioni, ampulë adrenaline, kollare qafë, shiringë sterile, termometër, doreza higjienike njëpërdorimëshe (5 copë), 1 flakon dezinfektant me betadinë, 3 flakonë solucioni fiziologjik (*chlorur sodium* - 0.9%) 500 ml, 10 garza sterile 10x10, 2 garza sterile 18x40, 2 peceta sterile njëpërdorimëshe, 2 pinca sterile njëpërdorimëshe, fashë llastiku e masës mesatare, pambuk absorbues, 2 leukoplastë të madhësive të ndryshme, 2 rrole leukoplasti me gjerësi 2.5cm, gërshërë, 3 llastikë hemostatikë, akull i gatshëm, qese higjienike njëpërdorimëshe).

Artikujt e kutisë së ndihmës mjekësore duhet të jenë brenda standardeve dhe afateve të përdorimit. Nuk duhet të ekspozohen ndaj diellit dhe temperaturave të larta.

UDHËZIM

Nr. 8, datë 11.10.2024

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË,
KRITEREVE DHE PROCEDURAT, PËR
VLERËSIMIN DHE PRIORITIZIMIN E
FONDEVE BUXHETORE TË
INVESTIMEVE PUBLIKE, PËR
OFRUESIT E SHËRBIMEVE NË
SEKTORIN E UJËSJELLËS-
KANALIZIMEVE**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 25/2023, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet

Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjiellës-Kanalizimeve në Shqipëri”,

UDHËZOJ:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Objekt i këtij udhëzimi është përcaktimi i metodologjisë, kriterëve dhe procedurave për vlerësimin dhe prioritizimin e fondeve buxhetore të investimeve publike, të cilat përfitohen nga ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjiellës-kanalizimeve në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 2
Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave, i procedurave dhe afateve që duhet të ndiqen në procesin e planifikimit dhe zbatimit të buxhetit nga Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizimeve në kuadër të përmirësimit të planifikimit, zbatimit, si dhe të rritjes së transparencës së përdorimit të fondeve buxhetore, me financim të brendshëm, në lidhje me Programin Buxhetor 06370 “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”.

2. Udhëzimi përcakton kriteret dhe procedurën e vlerësimit të projekteve, si dhe metodologjinë e prioritizimit të tyre, në bazë vlerësimi, me qëllim të përmirësimit të performancës operative dhe financiare të tyre duke inkurajuar efikasitetin më të mirë operacional përmes stimuljeve.

**Neni 3
Përcaktimi i politikave brenda Programit
Buxhetor**

1. Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizimeve (AKUK) është përgjegjëse për vlerësimin dhe prioritizimin e projekteve, që do të financohen nga Programi Buxhetor.

2. Politikat që janë objekt i këtij udhëzimi janë:



i. rritja e aksesit në ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë cilësor dhe të menaxhuar në mënyrë të sigurt;

ii. rritja e aksesit në ofrimin e shërbimeve me kanalizime dhe impiante të trajtimit të ujërave të ndotura;

iii. rritja e eficiencës në shërbimet e furnizimit me ujë;

iv. forcimi i kapaciteteve dhe modernizimi i ofruesve të shërbimeve në sektorin ujësjellës-kanalizime.

3. Projektet që do të vlerësohen, priorizohen dhe financohen do të detajohen si produkte brenda një prej politikave nga “i” deri “iv” të parashikuara në pikën 2 të këtij neni.

4. Ofruesit e shërbimeve në sektorin ujësjellës-kanalizime mund të aplikojnë për fonde sipas dispozitave të këtij udhëzimi për Programin Buxhetor 06370 “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, financim i brendshëm.

Neni 4

Subjektet përfituese

1. Subjektet që mund të aplikojnë për të përfituar nga një, ose disa prej politikave të programit buxhetor, janë:

a) ofruesit e shërbimeve në sektorin ujësjellës-kanalizime;

b) bashkitë mund të aplikojnë për projekte nëpërmjet ofruesve të shërbimeve në sektorin ujësjellës-kanalizime.

2. AKUK-ja mund të jetë autoritet kontraktor në rastet, kur:

a) janë investime prioritare të qeverisë;

b) janë investime që shtrihen në territorin e më shumë se një bashkie ose shoqërie;

c) janë investime të iniciuara nga vetë AKUK-ja;

d) projekti i zbatimit është përgatitur nga vetë AKUK-ja;

e) vlerësohet se shoqëritë nuk kanë kapacitetet e nevojshme për prokurimin dhe ndjekjen e zbatimit të investimit.

Neni 5

Buxheti, vlera financiare dhe periudha

1. Financimi i projekteve të investimeve publike bëhet në përputhje me metodologjinë e përgatitjes së buxhetit, miratuar nga ministria përgjegjëse për

financat, në udhëzimet standarde dhe vjetore të përgatitjes së buxhetit.

2. AKUK-ja përllogarit ndarjen e fondeve për një periudhë tre vjeçare duke priorizuar zhvillimin e politikave bazuar në Strategjinë Kombëtare dhe Buxhetin Afatmesëm të njoftuar nga Ministria e Financave. Përpara secilit cikël të aplikimeve, në janar dhe në shtator të çdo viti, i bën me dije ofruesve të shërbimeve në sektorin ujësjellës-kanalizime vlerën e fondeve të disponueshme për secilën politikë.

3. Fondet për investimet e planifikuara nga buxheti i shtetit për ofruesit e shërbimit në sektorin ujësjellës-kanalizime mund të përdoren për shlyerjen e vlerës nominale të aksioneve të MIE-s në shoqëritë rajonale të ujësjellës-kanalizime sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, për t'i mbështetur në përmbushjen e qëndrueshmërisë së tyre financiare, duke ofruar akses universal në shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve dhe për të zbutur ndikimin e investimeve kapitale në tarifat që u faturohen konsumatorëve.

KREU II

METODOLOGJIA E PËRFTIMIT TË FONDEVE

Neni 6

Kriteret e përgjithshme të përfitimit të fondeve për investime

1. Ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime mund të aplikojnë në AKUK për fonde sipas dispozitave të këtij udhëzimi.

2. Ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime do të kualifikohen për të aplikuar për fonde nëse plotësojnë të gjitha kërkesat e mëposhtme:

a) paraqet marrëveshjen e performancës, të nënshkruar nga AKUK-ja dhe shoqëritë, dhe ka përmbushur të paktën 50% të objektivave të përcaktuar në marrëveshjen e performancës. Për shoqëritë që kanë nënshkruar rishtazi marrëveshjen e performancës përjashtohen nga përmbushja e kërkesës së 50% të objektivave të përcaktuar në marrëveshje vetëm për periudhën vjetore në të cilën është nënshkruar marrëveshja;

b) nënshkruan letrën e pranimit, se pajtohet me formatin dhe periodicitetin e kërkesave të raportimit të AKUK-së;



c) përmbush kërkesat e qeverisjes qendrore dhe angazhimit qytetar, të tilla si, por pa u kufizuar në, përbërja e Këshillit Mbikëqyrës, monitorimi dhe mbikëqyrja financiare, kontabiliteti dhe raportimi financiar dhe raportimi dhe publikimi i treguesve kryesorë të performancës;

ç) ka një mekanizëm të qëndrueshëm dhe funksional për zgjidhjen e ankesave/sistemit të menaxhimit të ankesave dhe përdor portalin e shërbimit të klientit (www.shuk.al);

d) ka miratuar ose është në proces miratimit të Planit të Biznesit të vitit financiar përkatës.

3. Duke qenë se fondet do të përdoren për të mbështetur përfituesit në një ose më shumë prej 4 politikave të programit buxhetor të përcaktuara në nenin 3, pika 2, të këtij udhëzimi, për secilën fushë do të ketë 4 (katër) procedura aplikimi, forma financimi dhe shpenzime specifike të veçanta për përfitimin e fondeve sipas secilës prej politikave të parashikuara në këtë udhëzim.

Neni 7

Vlerësimi për përfitimin e fondeve për politikën “Rritja e aksesit në ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë cilësor dhe të menaxhuar në mënyrë të sigurt”

1. Objektivi i përgjithshëm i politikës “Rritja e aksesit në ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë cilësor dhe të menaxhuar në mënyrë të sigurt” është të zgjerojë dhe përmirësojë aksesin në furnizimin me ujë të sigurt dhe cilësor për popullatën, duke përfshirë familjet në nevojë, përmes zgjerimit dhe rehabilitimit të rrjeteve, lidhjeve shtëpiake dhe aseteve të tjera përkatëse (si rezervuarët, stacionet e pompimit dhe impiantet e trajtimit të ujit etj.).

2. Objektivi specifik është të ofrojë metodologjinë për vlerësimin e projekteve të investimeve kapitale dhe ndarjen e fondeve për të rritur aksesin e popullatës në sistemet e furnizimit me ujë të sigurt.

3. Ndërsa qëllimi specifik i projekteve të politikës “Rritja e aksesit në ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë cilësor dhe të menaxhuar në mënyrë të sigurt” është të mbështesë ofruesit e shërbimeve në sektorin ujësjellës-kanalizime në arritjen e qëndrueshmërisë financiare duke përmirësuar kapacitetin e tyre në sektorin e furnizimit me ujë dhe të zbusë ndikimin e investimeve kapitale në tarifatat që u faturohen konsumatorëve.

4. Politika “Rritja e aksesit në ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë cilësor dhe të menaxhuar në mënyrë të sigurt” përfshin dy linja fondesh për të zgjeruar dhe përmirësuar aksesin në furnizimin me ujë të sigurt dhe cilësor për popullatën që janë:

a) projektet që kanë në fokus kryesor lidhjet e reja të ujit;

b) projektet që kanë në fokus kryesor rritjen dhe përmirësimin e sistemeve të furnizimit me ujë.

5. Projektet që synojnë lidhjet e reja të ujit, do të konsiderojmë projektet që adresojnë shtimin e lidhjeve të reja funksionale të shërbimit të furnizimit me ujë me cilësi dhe sasi për familjet në nevojë, zonat pa sistem shërbimi të furnizimit me ujë, zonat periferike urbane dhe/ose rurale.

6. Projektet që synojnë rritjen dhe përmirësimin e sistemeve të furnizimit me ujë përfshijnë investime me fokus në të paktën një nga pikat e mëposhtme:

a) zgjerimi dhe rehabilitimi i sistemit të sigurimit të ujit (burime, puse, sigurimi i ujërave sipërfaqësore, kaptazhet);

b) zgjerimi dhe rehabilitimi i objekteve të trajtimit dhe dezinfektimit të ujit (p.sh. klorinimi);

c) zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjetit të shpërndarjes dhe rrjetit të transmetimit;

d) rehabilitimi/zëvendësimi i lidhjeve të shërbimit të furnizimit me ujë;

e) zgjerimi dhe rehabilitimi i stacioneve të pompimit;

f) zgjerimi dhe rehabilitimi i rezervuarëve të ujit;

g) ndërrimi i matësve të ujit në prodhim dhe të konsumatorit.

7. Projektet që kanë në fokus rritjen dhe përmirësimin e sistemeve të furnizimit me ujë mund të përfshijnë edhe investime në të paktën një nga pikat e mëposhtme:

a) automjete për operim dhe mirëmbajtje;

b) pajisjet për operim dhe mirëmbajtje;

c) ndërtesat e administratës;

d) ndërtesat për operim dhe mirëmbajtje (garazh, punishte, magazina etj.).

Neni 8

Procedura e vlerësimit të përfituesve për fonde për politikën “Rritja e aksesit në ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë cilësor dhe të menaxhuar në mënyrë të sigurt”

1. Ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime kualifikohen vetëm nëse ato përmbushin



kriteret e përgjithshme të kualifikimit përcaktuar në nenin 6, kreu II “Metodologjia e përfitimit të fondeve”, më sipër.

2. Ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime duhet të dorëzojnë një aplikim të nënshkruar dhe të plotë që përmban dokumentet dhe formularët në përputhje me aneksin 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, thënë ndryshe formularët e dorëzimit. Dorëzimi mund të bëhet me postë ose në protokollin e AKUK-së. Gjithashtu, ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime kanë mundësinë e paraqitjes së aplikimit në mënyrë elektronike.

3. Aplikimet duhet të dorëzohen gjatë periudhës së dorëzimit të aplikimeve, e cila zgjat çdo vit, nga 1 mars deri më 30 qershor – periudha e parë – dhe nga 1 tetori deri më 30 nëntor – periudha e dytë.

Neni 9

Metodologjia e vlerësimit të përfitimit të fondeve për politikën “Rritja e aksesit në ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë cilësor dhe të menaxhuar në mënyrë të sigurt”

1. Metodologjia për vlerësimin dhe renditjen e projekteve sipas prioriteteve të politikës “Rritja e aksesit në ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë cilësor dhe të menaxhuar në mënyrë të sigurt” bazohet në një qasje me dy hapa:

- a) Hapi i 1-rë: Shqyrtimi i përputhshmërisë;
- b) Hapi i 2-të: Vlerësimi dhe prioritizimi.

2. **Hapi i 1-rë:** Shqyrtimi i përputhshmërisë konsiston në vlerësimin e kërkesave të përcaktuara në nenin 7.2 të kreut II “Procedura e vlerësimit të përfituesve të fondeve”, më sipër.

3. **Hapi i 2-të:** Vlerësimi dhe prioritizimi i aplikimeve të projekteve bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) Projektet që kanë në fokus shtimin e lidhjeve të reja të ujit do të vlerësohen me formulën e mëposhtme të pikëzimit:

$$PS\ 3.1 = A + B + C + D$$

Ku:

“PS 3.1” do të thotë rezultati i Projektit sipas politikës “Rritja e aksesit në ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë cilësor dhe të menaxhuar në mënyrë të sigurt”, që janë projektet me fokus në lidhjet e reja të ujit;

“A” nënkupton kriteret strategjike – përafrimi me Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023–2030

$$A = A.1 \times 0,1$$

“B” nënkupton kriterin “Tipi i projektit” – ndikimi në shërbimet e furnizimit me ujë

$$B = B.1 \times 0,1 + B.2 \times 0,1$$

“C” nënkupton kriteret specifike për projektet që synojnë lidhjet e reja të ujit:

$$C = C.1.1 \times 0,1 + C.1.2 \times 0,1 + C.2.1 \times 0,05 + C.2.2 \times 0,05 + C.3.1 \times 0,05 + C.4.1 \times 0,05$$

“D” nënkupton kriteret e bashkëfinancimit

$$D = D.1 \times 0,3$$

b) Projektet që trajtojnë rritjen dhe përmirësimin e sistemeve të furnizimit me ujë do të vlerësohen me formulën e mëposhtme të pikëzimit:

$$PS\ 3.2 = A + B + C + D$$

Ku:

“PS 3.2” nënkupton totalin e pikëve gjithsej të projektit sipas politikës “Rritja e aksesit në ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë cilësor dhe të menaxhuar në mënyrë të sigurt”, që janë, Projekti që synon rritjen dhe përmirësimin e sistemeve të furnizimit me ujë, ku:

“A” nënkupton kriteret strategjike – përafrimi me Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023–2030

$$A = A.1 \times 0,1 + A.2 \times 0,1$$

“B” nënkupton kriterin “Tipi i projektit” – ndikimi në shërbimet e furnizimit me ujë

$$B = B.1 \times 0,05 + B.2 \times 0,05$$

“C” nënkupton kriteret specifike për projektet që trajtojnë rritjen dhe përmirësimin e sistemeve të furnizimit me ujë

$$C = C.1.1 \times 0,2 + C.1.2 \times 0,05 + C.2.1 \times 0,05 + C.2.2 \times 0,05 + C.2.3 \times 0,05 + C.3.1 \times 0,05 + C.3.2 \times 0,05 + C.4.1 \times 0,05 + C.4.2 \times 0,05$$

“D” nënkupton kriteret e bashkëfinancimit

$$D = D.1 \times 0,1$$

c) Përshkrimi i detajuar i kriterëve është në aneksin II – tabelat e vlerësimit.

4. Vlerësimi i aplikimeve bëhet nga AKUK-ja, i cili do t’i renditë aplikimet e dorëzuara për projekt sipas pikëve gjithsej të tyre. Aplikimet që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në nenin 8 të kreut II, më sipër nuk do të përzgjidhen.

5. Projektet që nuk marrin një minimum prej 40% sipas formulës së parashikuar në nenin 9, pika 3, më sipër specifikisht në hapin e 2-të, nuk do të përzgjidhet.



6. Pavarësisht nga pikët minimale të përcaktuara më lart, nëse vlera gjithsej e projekteve është mbi fondin gjithsej në dispozicion, projektet do të zgjidhen nëpërmjet priorizimit, duke filluar nga projekti me pikët më të larta, deri në më të ulët brenda financimit total të disponueshëm.

Neni 10

Vlerësimi për përfitimin e fondeve për politikën “Rritja e aksesit në ofrimin e shërbimeve me kanalizime dhe impiante të trajtimit të ujërave të ndotura”

1. Objektivi i përgjithshëm i politikës “Rritja e aksesit në ofrimin e shërbimeve me kanalizime dhe impiante të trajtimit të ujërave të ndotura” është të zgjerojë dhe përmirësojë aksesin në shërbime të sigurta dhe cilësore të kanalizimeve dhe impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura për popullatën duke përfshirë familjet në nevojë, përmes zgjerimit dhe rehabilitimit të rrjeteve, lidhjeve shtëpiake dhe aseteve të tjera përkatëse (stacionet e pompimit dhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura).

2. Objektivi specifik është të ofrojë metodologjinë për vlerësimin e projekteve të investimeve kapitale dhe ndarjen e granteve për të rritur aksesin e popullatës në sistemet e sigurta të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

3. Ndërsa qëllimi specifik i projekteve të politikës “Rritja e aksesit në ofrimin e shërbimeve me kanalizime dhe impiante të trajtimit të ujërave të ndotura” është të mbështesë ofruesit e shërbimeve në sektorin ujësjellës-kanalizime në arritjen e qëndrueshmërisë financiare duke përmirësuar kapacitetin e tyre në ofrimin e shërbimeve në kanalizime dhe impiante të trajtimit të ujërave të ndotura, si dhe të zbusë ndikimin e investimeve kapitale në tarifat që u faturohen konsumatorëve.

4. Politika “Rritja e aksesit në ofrimin e shërbimeve me kanalizime dhe impiante të trajtimit të ujërave të ndotura” ofron fonde për të rritur aksesin në shërbimet e kanalizimeve të menaxhuara në mënyrë të sigurt duke mbështetur projekte që mbulojnë, të paktën, një nga pikat e mëposhtme:

a) zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjeteve të kanalizimeve;

b) zgjerimi dhe rehabilitimi i kolektorëve kryesorë të ujërave të ndotura;

c) zgjerimi dhe rehabilitimi i stacioneve të pompimit të ujërave të ndotura;

d) zgjerimi dhe rehabilitimi i lidhjeve të shërbimit të ujërave të ndotura;

e) zgjerimi dhe rehabilitimi i impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura;

f) shtimi dhe rehabilitimi i aseteve të nevojshme për menaxhimin e llumit të ujërave të ndotura.

5. Projektet mund të mbulojnë edhe sistemet individuale të vogla të trajtimit të ujërave të ndotura.

6. Projektet që synojnë rritjen dhe përmirësimin e sistemeve të ujërave të ndotura mund të përfshijnë edhe investime në të paktën një nga pikat e mëposhtme:

a) automjete për operim dhe mirëmbajtje;

b) pajisje për operim dhe mirëmbajtje;

c) ndërtesat e administratës;

d) ndërtesat për operim dhe mirëmbajtje (garazh, punishte, magazina etj.).

Neni 11

Procedura e vlerësimit të përfituesve për fonde për politikën “Rritja e aksesit në ofrimin e shërbimeve me kanalizime dhe impiante të trajtimit të ujërave të ndotura”

1. Ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime kualifikohen vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përgjithshme të kualifikimit përcaktuar në nenin 6, kreu II “Metodologjia e përfitimit të fondeve”, më sipër.

2. Ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime duhet të dorëzojnë një aplikim të nënshkruar dhe të plotë që përmban dokumentet dhe formularët në përputhje me aneksin 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, thënë ndryshe – formularët e dorëzimit. Dorëzimi mund të bëhet me postë ose në protokollin e AKUK-së. Gjithashtu, ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime kanë mundësinë e paraqitjes së aplikimit në mënyrë elektronike.

3. Aplikimet duhet të dorëzohen gjatë periudhës së dorëzimit të aplikimeve, e cila zgjat çdo vit, nga 1 mars deri më 30 qershor – periudha e parë – dhe nga 1 tetori deri më 30 nëntor – periudha e dytë.



Neni 12

Metodologjia e vlerësimit të përfitimit të fondeve për politikën “Rritja e aksesit në ofrimin e shërbimeve me kanalizime dhe impiante të trajtimit të ujërave të ndotura

1. Metodologjia për vlerësimin dhe renditjen sipas prioritetit e projekteve të politikës “Rritja e aksesit në ofrimin e shërbimeve me kanalizime dhe impiante të trajtimit të ujërave të ndotura” bazohet në një qasje me dy hapa:

- a) **Hapi i 1-rë:** Shqyrtimi i përputhshmërisë;
- b) **Hapi i 2-të:** Vlerësimi dhe priorizimi.

2. **Hapi i 1-rë:** Shqyrtimi i përputhshmërisë konsiston në vlerësimin e kërkesave të përcaktuara në nenin 11 të kreut II më sipër.

3. **Hapi i 2-të:** Vlerësimi dhe priorizimi i aplikimeve bazohet në kriteret e mëposhtme:

$$PS\ 4 = A + B + C + D$$

Ku:

“PS 4” do të thotë totali pikëve të Projektit për politikën “Rritja e aksesit në ofrimin e shërbimeve me kanalizime dhe impiante të trajtimit të ujërave të ndotura”, ku bëjnë pjesë projektet që synojnë rritjen dhe përmirësimin e sistemeve të kanalizimeve, dhe impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura;

“A” nënkupton kriteret strategjike – përafrimi me Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023–2030

$$A = A.1 \times 0,1 + A.2 \times 0,1$$

“B” nënkupton kriterin e “Tipi i projektit” – ndikimi në shërbimet sanitare

$$B = B.1 \times 0,05 + B.2 \times 0,05$$

“C” nënkupton kriteret specifike për projektet që synojnë rritjen dhe përmirësimin e sistemeve të kanalizimeve, impianteve trajtimit të ujërave të ndotura:

$$C = C.1.1 \times 0,2 + C.1.2 \times 0,05 + C.2.1 \times 0,05 + C.2.2 \times 0,05 + C.2.3 \times 0,05 + C.3.1 \times 0,05 + C.3.2 \times 0,05 + C.4.1 \times 0,05 + C.4.2 \times 0,05$$

“D” nënkupton kriteret e bashkëfinancimit

$$D = D.1 \times 0,1$$

4. Përshkrimi i detajuar i kriterëve është dhënë në aneksin II – tabelat e vlerësimit

5. Vlerësimi i aplikimeve bëhet nga AKUK-ja, i cili do të bëjë priorizimin duke renditur aplikimet sipas pikëve totale. Aplikimet që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në nenin 11 të kreu II, më sipër nuk do të përzgjidhen.

6. Projektet që nuk marrin një minimum prej 40% sipas formulës së parashikuar në nenin 12, më sipër specifikisht në hapin e 2-të, nuk do të përzgjidhen.

Neni 13

Politika “Rritja e eficiencës në shërbimet e furnizimit me ujë”

1. Fondet që do të mbulojë kjo politikë kanë si objektiv të përgjithshëm mbështetjen dhe përmirësimin e eficiencës operationale të shoqërive, konkretisht përmes menaxhimit efikas të burimeve, duke përfshirë kontrollin dhe reduktimin e humbjeve dhe përmirësimin e eficiencës së energjisë.

2. Objektiv i specifik është të ofrojë metodologjinë për vlerësimin e projekteve të investimeve kapitale dhe ndarjen e fondeve, për të përmirësuar performancën operative dhe financiare të ofruesve të shërbimit në sektorin ujësjellës-kanalizime dhe nxitur drejt efikasitetit më të mirë operacional përmes stimuljeve.

3. Ndërsa qëllimi specifik i projekteve të politikës “Rritja e eficiencës në shërbimet e furnizimit me ujë” është të mbështesë ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime në arritjen e qëndrueshmërisë financiare dhe të zbusë ndikimin e investimeve kapitale në tarifat që u faturohen konsumatorëve.

Neni 14

Vlerësimi për përfitimin e fondeve për politikën “Rritja e eficiencës në shërbimet e furnizimit me ujë”

1. Politika e qeverisë shqiptare në rritjen e efikasitetit të shërbimeve të furnizimit me ujë përfshin tre linja fondesh, për:

a) projektet që synojnë në reduktimin e ujit pa të ardhura;

b) projektet që synojnë në përmirësimin e eficiencës së energjisë;

c) projektet që synojnë në reduktimin e ujit pa të ardhura dhe përmirësimin e eficiencës së energjisë, së bashku.

2. Projektet që synojnë në reduktimin e ujit pa të ardhura vlerësohen të pranueshme për përfitimin e fondeve nëse lidhen me përmirësimet e infrastrukturës që synojnë përmirësimin e vazhdimësisë së furnizimit me ujë me fokus të



veçantë në zonat urbane, zonat turistike dhe/ose zonat bregdetare, dhe përfshijnë investime në, të paktën, një nga zërat e mëposhtëm:

- a) reduktimi i humbjeve në linjat e transmetimit ose shpërndarjes;
- b) reduktimi i humbjeve dhe tejmbushjeve në rezervuarë (depot e ujit);
- c) reduktimi i humbjeve në rrjetin shpërndarës;
- d) vendosja e matësve në nënzona dhe krijimi i District Metered Area (DMA);
- e) zbatimi i strategjive dhe zgjidhjeve për menaxhimin e presionit;
- f) blerja dhe instalimi i matësve të ujit në prodhim dhe për konsumatorët fundorë;
- g) implementimi i sistemeve, pajisjeve dhe mjeteve të monitorimit të humbjeve.

3. Projektet që synojnë përmirësimin e eficiencës së energjisë vlerësohen të pranueshme për përfitimin e fondeve nëse përfshijnë investime në, të paktën, në një nga pikat e mëposhtme:

- a) vendosja e pompave të ujit me eficiencë energjie;
- b) të jetë pjesë e të paktën 10 shoqërive UK me konsumin më të lartë të energjisë dhe të ketë arritur të paktën 20% kursime të energjisë në sistemet e saj të furnizimit me ujë në momentin e aplikimit;
- c) të synojë prodhimin e energjisë së rinovueshme nëpërmjet energjisë diellore ose eolike.

4. Projektet që synojnë në reduktimin e ujit pa të ardhura dhe përmirësimin e eficiencës së energjisë, së bashku, vlerësohen të pranueshme për përfitimin e fondeve nëse përmbushin kërkesat parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

Neni 15

Procedura e vlerësimit të përfituesve për fonde për politikën “Rritja e eficiencës në shërbimet e furnizimit me ujë”

1. Ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime kualifikohen vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përgjithshme të kualifikimit përcaktuar në nenin 6, kreu II “Metodologjia e përfitimit të fondeve”, të këtij udhëzimi.

2. Për projektet që trajtojnë eficiencën e energjisë, ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime duhet të paraqesin dëshmi se kanë kryer Auditim të Eficiencës së Energjisë.

3. Projektet investimit të kombinuara që synojnë reduktimin e ujit pa të ardhura dhe përmirësimin e

eficiencës së energjisë duhet të përmbajnë investimet në të dyja pikat.

4. Ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime duhet të dorëzojnë një aplikim të nënshkruar dhe të plotë që përmban dokumentet dhe formularët në përputhje me aneksin 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, thënë ndryshe – formularët e dorëzimit. Dorëzimi mund të bëhet me postë ose në protokollin e AKUK-së. Gjithashtu, ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime kanë mundësinë e paraqitjes së aplikimit në mënyrë elektronike.

5. Aplikimet duhet të dorëzohen gjatë periudhës së dorëzimit të aplikimeve, e cila zgjat çdo vit, nga 1 mars deri më 30 qershor – periudha e parë – dhe nga 1 tetori deri më 30 nëntor – periudha e dytë.

Neni 16

Metodologjia e vlerësimit të përfitimit të fondeve

1. Metodologjia për vlerësimin dhe prioritizimin e projekteve të politikës “Rritja e eficiencës në shërbimet e furnizimit me ujë” bazohet në një qasje me dy hapa:

- a) Hapi i 1-rë: Shqyrtimi i përshtatshmërisë;
- b) Hapi i 2-të: Vlerësimi dhe prioritizimi.

2. **Hapi i 1-rë:** shqyrtimi i përshtatshmërisë konsiston në vlerësimin e kërkesave të përcaktuara në nenin 9, pika 2, të kreut II “Procedura e vlerësimit të përfituesve të fondeve”, më sipër.

3. **Hapi i 2-të:** vlerësimi dhe renditja e aplikimeve bazohet në kriteret e prioritizimit më poshtë:

a) Projektet që synojnë reduktimin e ujit pa të ardhura do të vlerësohen me formulën e mëposhtme të pikëzimit:

$$PS\ 1.1 = A + B + C + D$$

Ku:

“PS1.1” nënkupton rezultatin e projektit për politikën “Rritja e eficiencës në shërbimet e furnizimit me ujë”, pra projektet që synojnë reduktimin e ujit pa të ardhura;

“A” nënkupton kriteret strategjike - përafrimi me Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023–2030

$$A = A.1 \times 0,1$$

“B” nënkupton kriterin e “Tipi i projektit” – ndikimi në shërbimet e furnizimit me ujë

$$B = B.1 \times 0,1 + B.2 \times 0,1$$



“C” nënkupton kriteret specifike për projektet që synojnë reduktimin e ujit pa të ardhura

$$C = C.1.1 \times 0.05 + C.1.2 \times 0.05 + C.1.3 \times 0.05 + C.1.4 \times 0.05 + C.2.1 \times 0.15 + C.2.2 \times 0.05 + C.3.1 \times 0.05 + C.3.2 \times 0.05 + C.4.1 \times 0.05 + C.4.2 \times 0.05$$

“D” nënkupton Kriteret e Bashkëfinancimit

$$D = D.1 \times 0,1$$

b) Projektet që synojnë përmirësimin e eficiencës të energjisë do të vlerësohen me formulën e mëposhtme të pikëzimit:

$$PS\ 1.2 = A + B + C + D$$

Ku:

“PS1.2” nënkupton totalin e pikëve gjithsej të Projektit për Politikën “Rritja e eficiencës në shërbimet e furnizimit me ujë”, projektet që synojnë përmirësimin e eficiencës së energjisë;

“A” nënkupton kriteret strategjike – përafrimi me Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023–2030

$$A = A.1 \times 0,1$$

“B” nënkupton kriteret – lloji i masës – ndikimi në shërbimet e furnizimit me ujë

$$B = B.1 \times 0.05 + B.2 \times 0.05$$

“C” nënkupton kriteret specifike për projektet që synojnë përmirësimin e eficiencës të energjisë

$$C = C.1.1 \times 0.1 + C.1.2 \times 0.05 + C.1.3 \times 0.05 + C.2.1 \times 0.1 + C.2.2 \times 0.05 + C.3.1 \times 0,05 + C.3.2 \times 0.05 + C.3.3 \times 0.05 + C.4.1 \times 0.05 + C.4.2 \times 0.1 + C.5.1 \times 0.05$$

“D” nënkupton kriteret e bashkëfinancimit

$$D = D.1 \times 0,1$$

c) Projektet e kombinuara që synojnë reduktimin e ujit pa të ardhura dhe përmirësimin e eficiencës së energjisë do të rriten me 10% në pikët e tyre, duke rezultuar në formulën e mëposhtme të pikëzimit:

$$PS\ 1,3 = ([PS1,1] \times 1.1 + [PS1,2] \times 1.1) / 2$$

Ku:

“PS 1.3” do të thotë totali i pikëve gjithsej i Projektit për projektet që synojnë reduktimin e ujit pa të ardhura dhe përmirësimin e eficiencës të energjisë, të kombinuara.

4. Përshkrimi i detajuar i kriterëve është në aneksin II, bashkëlidhur me këtë udhëzim – tabelat e vlerësimit.

5. Vlerësimi i aplikimeve bëhet nga AKUK-ja, i cili do të rendisë aplikimet e dorëzuara sipas totalit të pikëve të tyre. Aplikimet që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në nenin 15 të kreut II, më sipër nuk do të përzgjidhen.

6. Projektet që nuk marrin një minimum prej 40% të pikëve sipas formulës së parashikuar në nenin 16, më sipër specifikisht në hapin e 2-të, nuk do të përzgjidhen.

7. Pavarësisht nga pikët minimale të përcaktuara në numrin e mëparshëm, nëse vlera gjithsej e projekteve është mbi fondin gjithsej në dispozicion, projektet do të zgjidhen nëpërmjet priorizimit, duke filluar nga projekti me pikët më të larta, deri në më të ulët brenda financimit total të disponueshëm.

Neni 17

Vlerësimi për përfitimin e fondeve për politikën “Forcimi i kapaciteteve dhe modernizimi i ofruesve të shërbimeve në sektorin ujësjellës-kanalizime”

1. Sipas VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikën kombëtare për riorganizimin e furnizimit me ujë dhe largimin, trajtimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura”, qeveria angazhohet të garantojë qëndrueshmërinë e ofruesve të shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime dhe përballueshmërinë e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime. Fondet që do të mbulojnë politikën “Forcimi i kapaciteteve dhe modernizimi i ofruesve të shërbimeve në sektorin ujësjellës-kanalizime” kanë si objektiv të përgjithshëm mbështetjen e ofruesve të shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime në konsolidimin e suksesshëm të procesit të rajonalizimit me synimin për të nxitur transformimin e qëndrueshëm të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, për të udhëhequr ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime në procesin e përmirësimit të kapaciteteve të tyre teknike, operationale dhe menaxhuese.

2. Objektivi specifik është ofrimi dhe zbatimi i metodologjisë për vlerësimin e projekteve dhe ndarjen e fondeve për përmirësimin e performancës operative dhe financiare të ofruesve të shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime.

3. Ndërsa qëllimi specifik i projekteve të politikës “Forcimi i kapaciteteve dhe modernizimi i ofruesve të shërbimeve në sektorin ujësjellës-kanalizime” është të mbështesë ofruesit e shërbimeve në sektorin ujësjellës-kanalizime në arritjen e qëndrueshmërisë financiare dhe përmirësimin e kapacitetit të tyre dhe



të zbusë ndikimin e investimeve kapitale në tarifatat që u faturohen konsumatorëve.

4. Politika për forcimin e kapaciteteve dhe modernizimin e ofruesve të shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime mbështet projekte që mbulojnë, të paktën, një nga pikat e mëposhtme:

a) përmirësimi i funksionimit operacional dhe organizativ të ofruesve të shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime;

b) forcimi i proceseve kyçe të ofruesve të shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime;

c) optimizimi i burimeve të ofruesve të shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime;

d) përmirësimi i standardeve të cilësisë së operacioneve;

e) ofrimi i shërbimeve të besueshme, të sigurt, gjithëpërfshirëse, transparente dhe të përgjegjshme, duke u fokusuar në:

i. sigurimin me furnizim të vazhdueshëm 24/7;

ii. respektimin e standarteve të cilësisë;

iii. mospërfshirjen e asnjë grupi nga ofrimi i shërbimit dhe/ose brenda ofruesve të shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime;

iv. forcimin e transparencës duke publikuar informacione të qarta dhe të sakta financiare, operacionale dhe të performancës;

v. forcimin e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime duke u ofruar konsumatorëve përgjigje në kohë, zgjidhje cilësore të problematikave dhe me fokus kënaqësinë e klientit;

f) Integrimi dhe uniformizimi i sistemeve dhe i proceseve të ish-shoqërive në SHRUK;

g) Forcimi dhe modernizimi i organizatës dhe fokusimi në:

i. strategjinë e biznesit dhe mjetet e menaxhimit;

ii. monitorimi dhe raportimi;

iii. efikasiteti dhe vazhdimësia;

iv. aftësitë menaxheriale;

v. qeverisja korporative dhe organizative;

h) Forcimi dhe modernizimi i menaxhimit tregtar, duke u fokusuar në:

i. menaxhim i marrëdhënieve me konsumatorët;

ii. shërbimi ndaj klientit;

iii. matjen;

iv. faturimi;

v. mbledhja e të ardhurave;

i) Forcimi dhe modernizimi i operacioneve teknike, duke u fokusuar në:

i. planifikimi i zgjerimit dhe rehabilitimit;

ii. mjetet e menaxhimit të aseteve (p.sh.: GIS, MIS, NIS, modeli hidraulik);

iii. proceset e operacioneve teknike;

iv. pajisjet elektronike të ruajtjes së informacionit në zyrë (kompjuterë etj.);

v. trajtimi dhe cilësia e ujit;

vi. menaxhimin e ujërave të ndotura dhe llumit fekal;

j) Forcimi dhe modernizimi i menaxhimit financiar, duke u fokusuar në:

i. strategjinë dhe menaxhimin;

ii. planifikimi dhe buxheti;

iii. kontabiliteti dhe raportimi financiar;

iv. kontrollin financiar dhe transparencën;

v. modeli dhe parashikimi financiar;

k) Forcimi dhe modernizimi i menaxhimit të burimeve njerëzore, duke u fokusuar në:

i. menaxhimin e burimeve njerëzore;

ii. rekrutimin;

iii. trajnimin dhe zhvillimin;

iv. menaxhimin e performancës;

v. shpërblimin nëpërmjet kompensimit, përfitimeve dhe mbajtjes në punë;

vi. kulturën dhe vlerat;

vii. diversitetin;

l) Ngritja e laboratorëve rajonale për monitorimin e cilësisë së ujit;

m) Vendosja e sistemeve automatike për dezinfektimin e ujit (klorinimin);

n) Adresimi i barazisë gjinore, duke kryer një studim për të kuptuar barrierat dhe për të vendosur objektiva, udhëheqje dhe programe trajnimi me akses të barabartë për femrat dhe mbështetje për rrjetet profesionale të grave në këtë sektor.

Neni 18

Procedura e vlerësimit të përfituesve për fonde për politikën “Forcimi i kapaciteteve dhe modernizimi i ofruesve të shërbimeve në sektorin ujësjellës-kanalizime”

1. Ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime kualifikohen vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përgjithshme të kualifikimit përcaktuar në nenin 6, kreu II “Metodologjia e Përfitimit të Fondeve”, më sipër.

2. Ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime duhet të dorëzojnë një aplikim të nënshkruar dhe të plotë që përmban dokumentet dhe formularët në përputhje me aneksin 1,



bashkëlidhur këtij udhëzimi – formularët e dorëzimit. Dorëzimi mund të bëhet me postë ose në protokollin e AKUK-së. Gjithashtu, ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime kanë mundësinë e paraqitjes së aplikimit në mënyrë elektronike.

3. Aplikimet duhet të dorëzohen gjatë periudhës së dorëzimit të aplikimeve, e cila zgjat çdo vit, nga 1 mars deri më 30 qershor – periudha e parë – dhe nga 1 tetori deri më 30 nëntor – periudha e dytë.

Neni 19

Metodologjia e vlerësimit të përfitimit të Fondeve për politikën “Forcimi i kapaciteteve dhe modernizimi i ofruesve të shërbimeve në sektorin ujësjellës-kanalizime”

1. Metodologjia për vlerësimin dhe prioritizimin e projekteve për politikën “Forcimi i kapaciteteve dhe modernizimi i ofruesve të shërbimeve në sektorin ujësjellës-kanalizime” bazohet në një qasje me dy hapa:

- a) Hapi i 1-rë: shqyrtimi i përshtatshmërisë;
- b) Hapi i 2-të: vlerësimi dhe prioritizimi.

2. **Hapi i 1-rë:** shqyrtimi i përshtatshmërisë konsiston në vlerësimin e kërkesave të përcaktuara në nenin 10.2 të kreut II “Procedura e vlerësimit të përfituesve të fondeve”, më sipër.

3. **Hapi i 2-të:** vlerësimi dhe renditja e aplikimeve bazohet në kriteret e prioritizimit më poshtë:

$$PS2 = A + B + C + D + E$$

Ku:

“PS2” do të thotë totali i pikëve të Projektit për politikën “Forcimi i kapaciteteve dhe modernizimi i ofruesve të shërbimeve në sektorin ujësjellës-kanalizime”;

“A” nënkupton kriteret strategjike – përafrimi me Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023–2030

$$A = A,1 \times 0,05 + A,2 \times 0,05 + A,3 \times 0,05 + A,4 \times 0,05$$

“B” nënkupton kriterin e “Tipi i projektit” – ndikimi në shërbimet e furnizimit me ujë

$$B = B,1 \times 0,05 + B,2 \times 0,05 + B,3 \times 0,05$$

“C” do të thotë kriteret specifike për projektet që synojnë forcimin e kapaciteteve dhe modernizimin e ofruesve të shërbimeve në sektorin ujësjellës-kanalizime

$$C = C,1 \times 0,05 + C,2 \times 0,05 + C,3 \times 0,05 + C,4 \times 0,05 + C,5 \times 0,05 + C,6 \times 0,05 + C,7 \times 0,05$$

“D” do të thotë Kriteret të Tjera Specifike

$$D = D,1 \times 0,05 + D,2 \times 0,05 + D,3 \times 0,05 + D,4 \times 0,05 + D,5 \times 0,05$$

$$\text{“E” nënkupton kriteret e bashkëfinancimit } E = E,1 \times 0,05$$

4. Përshkrimi i detajuar i kriterëve është në aneksin II – tabelat e vlerësimit.

5. Vlerësimi i aplikimeve bëhet nga AKUK-ja, i cili do të rendisë aplikimet e dorëzuara sipas pikëve totale të tyre. Aplikimet që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në nenin 18 të kreut II, më sipër nuk do të përzgjidhen.

6. Projektet që nuk marrin një minimum prej 40% sipas formulës së parashikuar në nenin 19, më sipër specififikisht në hapin e 2-të, nuk do të përzgjidhen.

7. Pavarësisht nga pikët minimale të përcaktuara më lart, nëse vlera totale e projekteve është mbi fondin total në dispozicion, projektet do të zgjidhen nëpërmjet prioritizimit, duke filluar nga projekti me pikët më të larta, deri në më të ulët brenda financimit total të disponueshëm.

Neni 20

Shpenzimet e pranueshme

1. Fondet e përfituara sipas një prej politikave nga “i” deri “iv” të cituara në nenin 3, pika 2, të këtij udhëzimi do të përdoren ekskluzivisht për investimet e përcaktuara në nenet 7, 10, 14, 17 të këtij udhëzimi. Fondet disbursohen nëpërmjet sistemit të thesarit vetëm nëpërmjet dorëzimit të faturave dhe dokumenteve të tjera provuese, sipas kërkesave të menaxhimit të thesarit.

2. AKUK-ja, në çdo kohë, mund të kërkojë dokumentacion teknik dhe financiar për të monitoruar përdorimin e fondeve dhe ecurinë fizike të investimeve.

Neni 21

Forma e financimit

1. Projektet që do të vlerësohen, prioritizohen dhe financohen si produkte brenda një prej politikave nga “i” deri “iv” të cituara në nenin 3, pika 2 të këtij udhëzimi mund të bashkëfinancohen nga bashkitë, ofruesit e shërbimeve në sektorin ujësjellës-kanalizime, ose donatorë.



2. Projektet e investimit nën shumën minimale të investimit nuk do të vlerësohen sipas këtij udhëzimi. Shuma minimale e investimit është 10 milionë lekë për koston totale të projektit (përfshirë projektimin, inxhinierinë, furnizim vendosjen, punimet e zbatimit dhe fondin rezervë sipas projektit nëse është i aplikueshëm).

Neni 22

Procedura e monitorimit

1. Aplikimet e miratuara dhe subjektet përfituese janë subjekt i monitorimit, kontrollit dhe auditimit që do të kryhen nga AKUK-ja dhe MIE-ja, si dhe nga autoritetet kombëtare përgjegjëse për certifikimin, auditimin dhe kontrollin e fondeve.

2. Fondet i nënshtrohen monitorimit dhe kontrollit të përdorimit të tij bazuar në legjislacionin në fuqi.

3. Shoqëritë përfituese të fondeve janë të detyruara të dorëzojnë raporte mujore me të dhënat informative që konsistojnë në:

- a) ecurinë e zbatimit të kontratës;
- b) numrin e familjeve që përfitojnë nga investimi, duke specifikuar më vete shtresat vulnerabël;

4. AKUK-ja, në çdo kohë, mund të kryejë mbikëqyrje ose auditime për të vlerësuar ecurinë e investimeve.

KREU III

KOMUNIKIMI DHE NDRYSHIMI I FONDEVE

Neni 23

Komunikimi

1. AKUK-ja dhe shoqëritë përfituese në mbështetje, duhet të:

- a) bëjnë publike disponueshmërinë e fondeve;
- b) nxisin aktivitete vjetore ndërgjegjësuere për të nxitur sjelljet drejt kursimit të ujit, ndalimin e lidhjeve të paligjshme dhe pagesën në kohë të faturave të ujit.

c) për projektet e miratuara sipas përcaktimeve ligjore të këtij udhëzimi, neni 7 më sipër që i referohen politikës “Rritja e aksesit në ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë cilësor dhe të menaxhuar në mënyrë të sigurt” dhe neni 10 më sipër që i referohen politikës “Rritja e aksesit në ofrimin e shërbimeve me kanalizime dhe impiante të

trajtimin të ujërave të ndotura”, çdo projekt duhet të shoqërohet nga një plan i fokusuar në fushatat e informimit, edukimit dhe komunikimit (FIEK) dhe komunikimit rreth ndryshimit të sjelljes konsumatore (KNS) me familjet e minoriteteve rome dhe grupe të tjera në nevojë për shtrirjen dhe aksesin në ujë dhe kanalizimet.

2. AKUK-ja dhe ofruesit e shërbimeve në sektorin ujësjellës-kanalizime përfituese të fondeve sipas projekteve të përcaktuara për politikën I deri IV parashikuara në nenin 3, të këtij udhëzimi, kanë koordinator informimi në organigramën e tyre që do të jetë person përgjegjës për komunikimin ndërmjet aktorëve përfshirës për menaxhimin e fondeve.

3. AKUK-ja ka të drejtë t'i kërkojë personit përgjegjës të ofruesve të shërbimeve në sektorin ujësjellës-kanalizime në çdo kohë informacione dhe sqarime për të vlerësuar ecurinë e investimeve.

Neni 24

Pakësimi ose heqja e fondeve

1. Në rast të mospërmbushjes së detyrimeve të përfituesit, nëse nga verifikimi rezulton mungesa ose humbja e përputhshmërisë së njërit prej kërkesave të specifikuara në nenet 9, 12, 16, 19 të kreut II më sipër mund të rezultojë në reduktimin ose revokimin e projektit.

2. Situatat e mëposhtme përbëjnë arsye të mjaftueshme për të përcaktuar pakësimin e mbështetjes për Projektin ose shpenzimet e tij:

a) mospërmbushje, tërësore ose e pjesshme, e detyrimeve të përfituesit, përfshirë rezultatet e kontraktuara;

b) kryerja e shpenzimeve që nuk lidhen me realizimin e Projektit ose të pajustificuara nëpërmjet faturave, apo dokumenteve të tjera të detyrueshme;

c) mosrespektimi i standardeve në lidhje me komunikimin;

d) mosrespektimi i legjislacionit kombëtar dhe rregulloreve specifike veçanërisht në çështjet e prokurimit publik dhe menaxhimit financiar;

e) mosrespektimi i detyrimit për regjistrimin e shpenzimeve dhe të ardhurave të Projektit në sistemin e kontabilitetit, në përputhje me ligjet në fuqi;

f) zbatimi i Projektit të miratuar nuk ka filluar sipas parashikimeve ligjore në kuadrin rregullues të prokurimit publik në Republikën e Shqipërisë, përveç rastit kur ekziston një arsye e justifikuar, e



paraqitur nga përfituesi dhe e pranuar nga AKUK-ja;

3. Pakësimi i financimit për investimin do të jetë në përpjesëtim me shkallën e mospërputhjes, sipas termave dhe kushteve që do të përcaktohen nga AKUK-ja.

4. Nëse situatat e sipërpërmendura vazhdojnë, mund të zbatohet revokimi i investimit.

5. Situatat e mëposhtme përbëjnë arsye për të përcaktuar revokimin e mbështetjes për investimin:

a) mosrespektimi i objektivave thelbësorë të përcaktuar në aplikimin e Projektit;

b) dështimi për të ekzekutuar plotësisht investimin sipas kushteve në të cilat është miratuar;

c) mosrespektimi i rregullave të përcaktuara në nenet 9, 12, 16, 19 të kreut II;

d) ndërprerja e paautorizuar e investimit për një periudhë më të gjatë se 120 ditë;

e) refuzimi, nga ana e përfituesve, për të dorëzuar raportimet periodike, ose për të dhënë informacion për grupet e monitorimit, kontrollit dhe auditimit të cilit i nënshtrohen ligjërisht;

f) dhënia e deklaratave të rreme që ndikojnë në mënyrë thelbësore në justifikimin e mbështetjes së marrë ose që do të merret.

KREU IV DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 25 Dispozitat kalimtare dhe të fundit

1. Për çdo paqartësi apo element tjetër që nuk është përfshirë në këtë udhëzim do të zbatohet

legjislacioni në fuqi për ndarjen e fondeve buxhetore dhe financimin publik.

2. Të gjitha kërkesat për projekte, të bëra përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të vlerësohen sipas dispozitave në fuqi përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

3. Dispozitat e këtij udhëzimi do të zbatohen për të gjitha kërkesat që do të bëhen nga subjektet përfituese, nga data 1.1.2025.

Neni 26 Institucionet që ngarkohen për zbatim

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizime dhe të gjithë ofruesit e shërbimeve në sektorin ujësjellës-kanalizime.

Neni 27 Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

ANEKSI 1 FORMULARI I DORËZIMIT

Seksioni 1: Informacion i përgjithshëm		
1.1	Emri i aplikuesit	
1.2	Fusha e aplikimit	
1.3	Titulli i Projektit	
1.4	Investimi i pritshëm [vlera përfshirë TVSH-në]	
1.5	Data e paraqitjes së aplikimit	
1.6	Informacioni i personit të kontaktit	Emri: E-mail: Telefoni:
Seksioni 2. Kriteret e përgjithshme/përshtatshmëria		
2.1	Marrëveshja e performancës e nënshkruar nga AKUK-ja dhe ofruesve të shërbimeve në sektorin ujësjellës-kanalizime	PO Marrëveshja nr. _____ prot., Datë:



